

ANEKSI NR. 1 B KUSHTET E VEÇANTA TË SHËRBIMEVE DHE TARIFAVE

Në këtë Aneks, pasqyrohen shërbimet bazë dhe shtesë të ofruara nga ONE dhe të zgjedhura nga Pajtimtari, kushtet e veçanta, tarifat përkatëse të shërbimeve si dhe mënyra e tarifimit.

- Plani Tarifor Unlimited Surf+

	Unlimited Surf+
Pajtimi Mujor	1400 Leke/muaj
Internet me shpejtesi maksimale	40GB
Internet me shpejtesi te reduktuar (256 kbps)	Pa Limit

SHËNIME TË PËRGJITHSHME

- 1) Të gjitha tarifat e përcaktuara më sipër përfshijnë TVSH-në.
- 2) Benefitet e përfshira në program janë të vlefshme për një periudhë 1 mujore dhe nuk janë të transferueshme në muajt në vijim.
- 3) Pajtimi mujor dhe njësitë të përfshira në plan (MB) janë proporcionale në varësi të datës së aktivizimit. Ky kusht aplikohet për të gjitha mënyrat e abonimit: aktivizim i ri, transferim, tjetërsim.
- 4) Përlllogaritja e konsumimit të internetit do të bëhet për çdo 10 KB.
- 5) Interneti pas përfundimit të njesive do të jete me shpejtesi te reduktuar 256kbps.
- 6) Pajtimtari mund të ndryshojë në çdo kohë planin e tij tarifor, në një plan tjetër tarifor me pajtim mujor më të lartë.
- 7) Kohëzgjatja fillestare, minimale e kontratës është 12 muaj. Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës prej Pajtimtarit brenda afatit fillestar 12 mujor apo 24 mujor, Pajtimtari ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerë e tarifën mujore fikse për të gjithë muajt e mbetur deri në përfundimin e afatit të kontratës 12 mujore ose 24 mujore.
- 8) Në rastet kur Pajtimtari ka përfituar një zbritje në çmimin e aparatit apo të një pajisje të marrë si ofertë specifike, dhe kërkon zgjidhje të parakohshme të kontratës, përveç penalitetit të shënuar më sipër dhe vlerës së plotë korresponduese të ofertës specifike, duhet të paguajë gjithashtu dhe vlerën korresponduese të zbritjes së përfituar në çmimin e aparatit.
- 9) Në rastet kur pajtimtari ka përfituar nga ndonjë ofertë promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promovionale, dhe vendos të kryejë zgjidhje të parakohshme të kontratës, së bashku me detyrimet e sipërpërmenduar duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 10) Në rast se Pajtimtari do të ndryshojë planin, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, ka detyrim të paguajë si penalitet vlerën e diferencës së pagesës fikse mujore për të gjithë muajt e mbetur.
- 11) Në rastet kur Pajtimtari ka përfituar një zbritje në çmimin e aparatit apo të ndonjë pajisje të marrë si ofertë specifike, dhe kërkon të beje ndryshim e planit, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, ka detyrim të paguajë si penalitet, përveç penalitetit të shënuar më sipër duhet të paguajë gjithashtu dhe vlerën korresponduese të zbritjes së përfituar në çmimin e aparatit.
- 12) Në rastet kur pajtimtari ka përfituar nga ndonjë ofertë promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promovionale, dhe vendos do të ndryshojë planin, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, së bashku me detyrimet e sipërpërmenduar duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 13) Në faturën e pare do të pasqyrohen deryrimi i muajit paraardhës (proporcional) dhe pagesa fikse mujore e muajit aktual. Pagesat fikse mujore në vijim do të aplikohen çdo datë 1 të muajit kalendarak. Në faturën mujore të lëshuar, do të shfaqet vetëm vlera e pagesës mujore fikse e muajit aktual, sipas planit tarifor të zgjedhur.